



## VENDIM

Nr.53 Datë 17.04.2015

### PËR

### DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN E LIDHJEVE TË REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.04.2015, mbasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Grupi i Punës për disa ndryshime në “Rregulloren lidhjeve të reja në sistemin e shpërndarjes” miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 22, datë 25.02.2012,

#### Duke konsideruar që :

-aktet nenligjore të miratuara nga ERE nuk mund të prevalojne mbi ligjin (konkretisht L i g j nr.8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”) e nuk duhet te çënojne hierarkinë e rregullave ;

-duke marrë në konsideratë dhe “Rekomandimet e Komisionerit për të drejtën e Informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale” sipas Urdhrit Nr.28, date 11.04.2014 të Komisionerit me qëllim që aktet e ERE-s të mos çenojnë rregullimet sipas akteve të tjera ligjore në fuqi,

-duke patur parasysh që sektori i Energjisë së shpejti pritet të rregullohet me një ligj të ri , i cili do të kërkojë hartimin e akteve të reja nën ligjore për t’u implementuar,

### Vendosi:

1-) Të mos miratoje ndryshimet e propozuara nga OSHEE sh.a. për sa i përket përjashtimit nga rregullorja të klauzolave që parashikojnë marrjen e miratimit paraprak nga IQT.

2-) Të mos miratojë ndryshimet e propozuara nga OSHEE sh.a. për të reflektuar ndryshime të tjera në Rregulloren e Lidhjeve të Reja.

3-) Të miratojë ndryshimin e propozuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ,Pika 3.1 klauzola 6 si vijon:

*“Vërtetim i pronësise së objektit nëpërmjet dokumentave të rregjistrimit të pronës,të tilla si : Akt shitje, akt qeraje, akt dhurimi ose akt ndarje prone të patundëshme. I gjithë informacioni i lidhjes së re si dhe kontrata e furnizimit të klientit ruhen nga kompania OSHEE në mënyrë elektronike dhe dokumentare” ne përputhje me përcaktimet e ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të tjera ligjore në*

*fuqi për mbrojtjen, përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale dhe të drejtës së informimit mbi to”.*

**4-) Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare

**KRYETARI i ERE-s**

**Petrit AHMETI**